

# Rregullat e pastërtisë

[ Albanian – Shqip – ألباني ]



**Abdurrahman El-Ued'an Ed-Deuseri**



**Përktheu: Jusuf Kastrati**

# أحكام الطهارة



عبد الرحمن بن فهد الودعان الدوسري



الترجمة: يوسف كاستراتي

## Rregullat e pastërtisë

### Rregullat e ujërave

#### Uji ndahet në dy lloje:

1. **I pastër**, që në arabisht quhet “tahir”.

Ujë i pastër quhet uji i cili nuk i ka ndryshuar vetitë e tij, siç është uji i shiut, i deteve, i lumenjve, i krojeve, etj.

2. **I papastër**, që në arabisht quhet “nexhis”.

Ujë i papastër quhet uji që ka ndryshuar ngjyrën, shijen ose aromën, për shkak të ndonjë ndyrësire që ka rënë në të, siç janë ujërat e zeza.

### Pastrimi nga ndyrësia

Pastrimi nga ndyrësia bëhet me çdo gjë që e heq atë, siç janë uji dhe të gjitha elementet bashkëkohore për pastrim, si për shembull pastrimi i rrobave me avull.

### Përdorimi i enëve

Lejohet të përdoren të gjitha enët e pastra për ngrënie, për pirje dhe për pastrim me to, përveç enëve të prodhuara nga floriri a argjendi ose atyre që janë të lyera me to.

### Rregullat e kryerjes së nevojës

1. Është sunet që para hyrjes në nevojtoare të thuhet “*bismillah*”<sup>1</sup> (me emrin e Allahut), “*Allahumme innij*

<sup>1</sup> Ibën Ebi Shejbe (5), Taberaniu në “El-Euset” (2910), kurse Ibën Haxheri thotë se isnadi i këtij hadithi i përmbush kushtet e Muslimit. Fet’hu’l-Bari (1/244). Albani e cilëson si “sahih” në “Sahih el-xhami’i” (4714). Shih po ashtu: Tirmidhiu (606) dhe Ibën Maxhe (297).

*euudhu bike min'el-hubuthi ue'l-habaith*" (O Allahu im, më ruaj nga të ndyrët dhe të ndyrat), siç përcillet në një hadith se i Dërguari i Allahut, Muhamedi, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, kur shkonte në nevojtoje thoshte: *"Allahumme innij euudhu bike min'el-hubuthi ue'l-habaith."*<sup>2</sup>

I Dërguari i Allahut, Muhamedi, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, thoshte gjithashtu: *"Mburoja ndërmjet xhinëve dhe aurretit (pjesëve të turpshmetë trupit) të njeriut kur hyn në nevojtoje është thënia bismillah (me emrin e Allahut)."*<sup>3</sup>

2. Pëlqehet që në nevojtoje të hyhet me këmbën e majtë dhe të dilet nga ajo me të djathtë.
3. Është sunet që pastrimi (pas kryerjes së nevojës) të bëhet me dorën e majtë, kurse urrehet që kjo të bëhet me të djathtë.
4. Urrehet mbajtja e organit gjenital me dorën e djathtë gjatë urinimit.
5. Pëlqehet të lahet mirë dora pas pastrimit, duke përdorur ujë dhe sapun ose të fërkohet me dhë dhe të lahet me ujë.
6. Është e ndaluar që gjatë kryerjes së nevojës në ndonjë vend të hapur të kthehem nga kibleja a t'ia kthejmë shpinën asaj. Mirëpo, nëse gjendemi brenda ndërtesave, atëherë kjo gjë nuk ndalohet.
7. Gjithnjë duhet të ruhem qe të mos na bie ndonjë ndyrësi në rroba a në trup, por nëse ndodh një gjë e tillë, atëherë jemi të detyruar ta pastrojmë atë, sepse i Dërguari i Allahut, paqja

<sup>2</sup> Buhariu (142), Muslimi (375).

<sup>3</sup> Tirmidhiu (606), Ibën Maxhe (298). Albani e cilëson si "sahih" në "Sahih el-xhami'i" (3610).

- dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Pjesa më e madhe e ndëshkimit në varr ndodh për shkak të urinës.”*<sup>4</sup>
8. Po qe se është e mundur që pas kryerjes së nevojës të pastrohemi së pari me letra a me gurë pastaj me ujë, do të ishte më së miri, sepse kjo është mënyra më e mirë e pastrimit. Pastrimi vetëm me letra a me gurë është i lejuar, mirëpo me kusht që të hiqet ndyrësia duke e fshirë atë tri herë ose më shumë se kaq.
  9. Nëse njeriu e kryen nevojën në ndonjë vend të hapur, atëherë është sunet që të shkojë diku, ku nuk mund ta shohë askush, ngase përcillet nga i Dërguari i Allahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, se *“kur dëshironte ta kryente nevojën largohet”*.<sup>5</sup>
  10. Kryerja e nevojës në rrugë a në vende që i shfrytëzojnë njerëzit për hije është rreptësisht e ndaluar, sepse i Dërguari i Allahut, Muhamedi, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Ruajuni dy mallkimeve!”* Shokët i thanë: *“Cilat janë dy mallkimet, o i Dërguar i Allahut?”* I Dërguari u përgjigj: *“Ai i cili e kryen nevojën në rrugë të njerëzve a në vende që i shfrytëzojnë për hije”*.<sup>6</sup>
  11. Hyrja në nevojtoare me Mus’haf (Kuran) a me ndonjë libër tjetër fetar është e ndaluar.
  12. Urrehet të hyhet në nevojtoare me çdo gjë në të cilën përmendet emri i Allahut, për të madhëruar kështu emrin e Allahut të Lartësuar, mirëpo kur kjo gjë është e nevojshme, për shembull, kur kemi frikë nga vjedhja a humbja e librit apo e fletëve të tij, atëherë hyrja me të nuk është e urryer.

<sup>4</sup> Ahmedi (2/326), Ibën Maxhe (348). Buhariu e cilëson si “sahih” siç gjendet në librin “el-‘ilel el-kebijr”, fq. 140. Darakutniju (1/128). Albani e cilëson si “sahih” në “Sahih el-xhami’i” (4651).

<sup>5</sup> Ahmedi (3/443), Ebu Davudi (1,2)

<sup>6</sup> Muslimi (269).

13. Është sunet që kur dalim nga nevojtorja të themi *“gufraneke”* (kërkoj faljen Tënde, o Zot), sepse Pejgamberi, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, thoshte kështu.<sup>7</sup>

**Marrë nga libri "Et-tuhfe el-islamijje li talibi'l-hidaje er-rabbanijje" i autorëve Ibrahim El-Ued'an, Muhammed El-Ued'an dhe Abdurrahman El-Ued'an**

---

<sup>7</sup> Ebu Davudi (30), Tirmidhiu (7). Tirmidhiu e cilëson si hadith *“hasen-garijb”*. Ebu Hatimi e cilëson si *“sahih”* (siç gjendet në librin *“Bulug’ul-meram”*, fq. 39). Neveviu në *“El-mexhmu’ë”* (2/94).